



Skema e grantit "IPARD-Like" bashkëfinancohet nga BE dhe Qeveria Shqiptare, zbatohet nga GIZ

THIRRJA E PARË PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE "IPARD-like" NR: 01/2012

pjesë e Marrëveshjes së Delegimit të BE-së nr. 2012/295-403

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) e Shqipërisë, në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) shpallin **Thirrjen e Parë për Dorëzimin e Aplikimeve të Skemës së Grantit "IPARD-like" për Zhvillimin e Sektorit Agro-Ushqimor në Shqipëri.**

Thirrja e parë do të qëndrojë e hapur nga data 18 Dhjetor 2012 deri në datën 18 Shkurt 2013, ora 16:00, sipas orës lokale.

Skema e Grantit "IPARD-like" zbatohet në kuadër të Projektit EU-IPA 2011 "Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural" (SARD) në përputhje me Marrëveshjen e Delegimit nr. 2012/295-403.

Skema e Grantit bashkë-financohet nga BE-ja me 75%, për të cilën pjesë Autoritet Kontraktues do të jetë GIZ, si dhe nga Qeveria e Shqipërisë me 25%, për të cilën pjesë Autoritet Kontraktues do të jetë AZHBR-ja.

Buxheti i përgjithshëm i parashikuar si **kontribut publik** për këtë thirrje është **8.270.000 EURO**, nga të cilat, 6.200.000 Euro janë pjesa e kontributit të Komunitetit dhe 2.070.000 Euro janë pjesa e kontributit Kombëtar.

Thirrja e parë është e hapur për të gjithë qytetarët e Shqipërisë, (persona fizikë dhe juridikë) të cilët punojnë dhe zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në fushat e prodhimit bujqësor dhe atë të agro-përpunimit në sektorët e qumështit, mishit, frutave dhe perimeve.

Të interesuarit mund të dorëzojnë Aplikime për dy Masa si vijon:

Masa 1 Investime në fermat bujqësore
Masa 2 Investime në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore.

Shpërndarja indikative e fondeve sipas masave është:

Për Masën 1 – 62% ose deri në 5,130,000 EURO;

Për Masën 2 – 38% ose deri në 3,140,000 EURO;

Totali i kostove të pranueshme për çdo aplikim për Masen 1 është:

- **Sasia minimale e totalit të kostove të pranueshme: EUR 2,500;**
- **Sasia maksimale e totalit të kostove të pranueshme: EUR 150,000.**
- **Per aplikimet ku totali i kostove të pranueshme është mbi 150,000 Euro dhe deri në maksimumin prej 300,000 Euro aplikohet rregullisht i meposhtem;**
 - Ne rastin kur aplikimi e tejkalon shumën e kostove të pranueshme prej 150,000 Euro dhe shkon deri në maksimumin e totalit të kostove të pranueshme prej 300,000 Euro, aplikimet do të merren në konsideratë për t'u kontraktuar vetëm nëse mbetet buxheti



Skema e grantit "IPARD-Like" bashkëfinancohet nga BE dhe Qeveria Shqiptare, zbatohet nga GIZ

disponibel dhe nese jane permbushur te gjitha kerkesat e tjera (kriteret e pranueshmerise dhe te perzgjedhjes duke perfshire kriteret e renditjes)

- **Totali i kostove të pranueshme për çdo aplikim per Masen 2 është:**
- **Sasia minimale e totalit te kostove te pranueshme: EUR 20,000;**
- **Sasia maksimale e totalit te kostove te pranueshme: EUR 500,000.**
- **Per ato aplikime ku totali i kostove te pranueshme eshte mbi 500,000 Euro dhe deri ne maksimumin prej 1,000,000 Euro aplikohet rregulli i meposhtem;**
 - Ne rastin kur aplikimi e tejkalon shumen e kostove te pranueshme prej 500,000 Euro dhe shkon deri ne maksimumin e totalit te kostove te pranueshme prej 1,000,000 Euro, aplikimet do te merren ne konsiderate per t'u kontraktuar vetem nese mbetet buxhet disponibel dhe nese jane permbushur te gjitha kerkesat e tjera (kriteret e pranueshmerise dhe te perzgjedhjes duke perfshire kriteret e renditjes)

Tavani i grantit si mbështetje nga sektori publik eshte deri në shkallën 50% të totalit të shpenzimeve të miratuara dhe ajo paguhet pas përfundimit të investimit nga ana e përfituesit.

Per Masën 1 përqindja e rimbursimit do të jetë më e madhe për ato investime të pranueshme që përmbushin kriteret e mëposhtme:

- 55% për fermerët e rinj (nën 40 vjec), 60% për investimet në zonat malore, dhe 65% për investimet në zonat malore dhe bere nga fermerët e rinj.

Të gjithë të interesuarit ftohen që ti drejtohen **Udhëzuesit për Aplikantët** ku do të mund të gjejnë në mënyrë të detajuar infomacionet e nevojshme për përgatitjen e aplikimeve: Informacione të tilla si: kriteret e pranueshmërisë, llojet e pranueshme të investimeve si edhe rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen dhe zbatimin e investimeve.

Duke filluar nga data 18/12/12 versionet e printuara Udhëzuesit për Aplikantët (falas) të do të shpërndahen në zyrat qendrore të AZHBR-së në MBUMK, Sheshi Skanderbej nr. 2, Tiranë, si edhe në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë (DRB) gjatë orarit zyrtar të punës, ose mund të shkarkohet gjithashtu nga faqet e internetit www.azhbr.gov.al dhe www.IPARD-like.al.

Informacioni lidhur me datat dhe vendet e zhvillimit të sesioneve informuese ne cdo Qark lidhur me këtë Thirrje për Aplikime mund të gjenden në: www.azhbr.gov.al; dhe www.IPARD-like.al

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen vetëm në zyrat qendrore të AZHBR-së në Tiranë dorazi (personalisht) ose me anë të shërbimeve postare ose postës rekomande, në adresën:

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
Sheshi Skanderbej nr. 2
1001 Tiranë, Shqipëri

Aplikimet per dorezim duhet te jene pergatitur ne kompjuter dhe te printuar, dhe dorezohen në një zarfi të mbyllur me shënimin përsipër "TË MOS HAPET PARA DORËZIMIT – DORËZUAR për THIRRJEN PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE "IPARD-like" nr. 01/2012" si edhe duke shënuar Masën për të cilin aplikimi është dorëzuar, së bashku me të gjitha dokumentet shoqëruese siç edhe tregohen në Udhëzuesin për Aplikantët.

Kujtese për aplikantët potencialë:



Skema e grantit "IPARD-Like" bashkëfinancohet nga BE dhe Qeveria Shqiptare, zbatohet nga GIZ

**Aplikimet e dërguara në ndonjë mënyrë tjetër (p.sh. me faks ose me e-mail) apo të dërguara në adresë tjetër nuk do të pranohen.
Çdo aplikim tjetër i dorëzuar ose i marrë pas përfundimit të afatit të kohëzgjatjes së thirrjes nuk do të konsiderohet i vlefshëm.**

Për informacione të mëtejshme mund të kontaktoni:

AZHBR:

Tel: +355 (0) 422 48 208

Email: info@azhbr.gov.al

GIZ :

Tel: +355 (0) 422 27 568

Email: SARD-IPARD@giz.de